

PKR.696/16

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, në përbërje nga gjyqtarja, Valbona Musliu-Selimaj, Kryetare e trupit gjykues, me procesmbajtësen Lindita Sylejmani, punëtore e kësaj gjykate, në çështjen penale, kundër të akuzuarës R.M, për shkak të veprës penale Keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPR-së, e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PPI.nr.379/2015, të dt.18.11.2016, në shqyrtimin fillestar, të hapur, verbale të mbajtur me dt.**27.04.2018**, në prezencë të prokurores së shtetit, Shemsije Asllani, të akuzuarës R.M, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

E akuzuara: **R.M**, nga i ati R. dhe nënës M, e gjinisë R, e lindur me dt...., në fshatin M. Komuna P. ku edhe jeton, me numër personal ..., ka të kryer shkollën fillore, e pa punë, e pa martuar, e gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës,

**Konform nenit 363 par.1 nën par 1.1 të KPPK-së,**

### REFUZOHET AKUZA

**S e p s e:** Me datën 08.06.2014, gjatë mbajtjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, e pandehura ka votuar me kusht në qendrën e votimit me numër të vendvotimit 1819E/03D, në shkollën fillore "Drita", në fshatin Majac Komuna e Podujevës, edhe pse e ka shfrytëzuar të drejtën dhe ka votuar si votuese e rregullte në të njëjtën qendër të votimit, me numër të vendvotimit 1819E/02R,-

- me çka kishte për të kryer veprën penale Keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPRK-së.

- Për shkak se Prokurorja e shtetit, është tërhequr nga aktakuza në seancën e shqyrtimit fillestar

- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

### A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PPI.nr.379/2015, të datës 18.11.2016, ka akuzuar R.M, për shkak të veprës penale Keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPRK-së.

Gjykata lidhur me këtë çështje caktoi dhe mbajti seancë shqyrtimit fillestar me datë 27.04.2018, ku e akuzuara pasi iu lexua aktakuza deklaroi se të njëjtën e ka të qartë, nuk ka nevojë për sqarime shtesë dhe deklaroi se ndihet e pafajshme pasi që ka votuar vetëm njëherë dhe atë me kusht, e ka identifikuar nënshkrimin e saj te lista e votuesve me kusht me nr. 1819E/03D dhe atë nën numrin 0022, respektivisht te emri i M.N, e që është i njëjti edhe te zarfi i fletëvotimeve me kusht të cilin nënshkrim e pranoj së është i saj, ndërsa nuk e pranoj nënshkrimin që figuron te lista e votuesve të rregullte, duke theksuar se nuk është nënshkrimi i saj.

Prokurorja e shtetit pas deklarimit të akuzuarës e cila nuk e pranojë fajësinë për veprën penale, deklaroi se pas sigurimit të raportit të ekspertizës nga Agjencioni i Forenzikës lidhur me identifikimin e nënshkrimeve nga e akuzuara të dhëna në seancën e fundit ku janë marrë mostrat nga e njëjta, po ashtu krahasimit të tyre me nënshkrimet që janë pjesë e dosjes së lëndës, nënshkrimi te listat e votuesve me kusht dhe votuesve të rregullte, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave, ekspertizës e cila vërtetoi thëniet e të akuzuarës se e njëjta ka votuar vetëm njëherë dhe atë me kusht e që identifikohen dhe janë në përputhshmëri të plotë me ekspertizën grafologjike, është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarës nuk janë përmbushur elementet e figurës së veprës penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, andaj konform nenit 52 të KPPRK-së, tërhiqet nga ndjekja penale ndaj të akuzuarës R.M.

Pasi që Prokurori i shtetit gjatë seancës së shqyrtimit fillestar u tërhoq nga ndjekja penale ndaj të akuzuarës R.M, gjykata në bazë të nenit 363 par.1 nëpar.1.1 të KPPRK-së, refuzoi Aktakuzën.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë në bazë të nenit 454, par. 1, të KPPK.

Nga sa u tha më lart dhe në bazë të nenit 363 par.1 nëpar.1.1 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për krime të rënda**  
**PKR.nr.696/16 dt.27.04.2018**

Procesmbajtësja  
 Lindita Sylejmani

---

**Kryetarja e trupit gjykues -GJYQTARJA**  
 Valbona Musliu-Selimaj

---

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.